

Programi: Parandalimi i trafikimit të qënieve njerëzore dhe mbështetja e viktimave të trafikimit në Shqipëri dhe rajon

Programi i Antitrafikimit lindi në vitin 2005 dhe ka në fokus parandalimin e trafikimit duke përfunduar kapacitetet e stafit dhe të gjithë bashkëpunëtorëve në terren për të informuar dhe sensibilizuar për problemin e trafikimit të qënieve njerëzore komunitetin në tërësi. Qëllimi i këtij programi është të reduktojë trafikimin e qënieve njerëzore në Shqipëri dhe rajon duke bashkëpunuar me institucionet dhe OJF-të për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

Gjithashtu ky program ka dy linja kryesore:

- ✚ Në nivel kombëtar fokusohet në identifikimin e grave dhe fëmijëve në risk duke iu ofruar atyre mundësi për edukim, zhvillim dhe punësim, si dhe duke i mbajtur larg rreziqeve, duke u ofruar alternativa nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si kurse profesionale, informim dhe edukim nëpërmjet kampeve verore, fushatave ndërgjegjësuëse, takimeve informuese dhe konsultuese etj. Pjesë e grupit të punës janë stafet e Caritas-eve Dioqezane dhe misionarët që punojnë në vendin tonë dhe menaxhojnë qendrat sociale dhe shëndetësore. Gjithashtu ky program mbështet edhe nismat e përbashkëta me organizatat e tjera për të advokuar dhe lobuar kundër shfrytëzimit dhe trafikimit të fëmijëve, shkëmbime përvojash, bashkëpunime dhe nisma kombëtare në përkrahjen e personave vulnerabël dhe në risk ndaj trafikimit. Programi zbatohet në nivel dioqezan dhe ka angazhuar shumë të rinj dhe vullnetarë, të cilët pasi janë trajnuar nga stafi i projektit dhe ekspertë të jashtëm kanë ofruar shërbime dhe kanë organizuar aktivitete të ndryshme në lidhje me këtë çështje. Përfituesit e drejtpërdrejtë janë fëmijët, të rinjtë, gratë dhe vajzat; përfituesit jo të drejtpërdrejtë janë familjarët dhe komuniteti në tërësi, veçanërisht persona që jetojnë në zona të ndryshme të vendit tonë, të cilët janë pjesë e programeve të ndryshme që implementohen nga projektet e Caritasit.
- ✚ Në nivel Euro-Mesdhetar ky program përfshin 11 Caritas-e partnere nga Evropa dhe zona e Mesdheut: Shqipëria, Armenia, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Franca, Kosova, Libani, Rumania, Turqia, Maroku dhe Ukraina, të cilët janë përfshirë në punën kundër trafikimit njerëzor dhe synon promovimin dhe forcimin e bashkëpunimit mes vendeve evropiane dhe mesdhetare për të përmirësuar dhe për të përshpejtuar përpjekjet ekzistuese kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Shkëmbimi i praktikave dhe përvojave në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore ka pasuruar praktikën dhe metodat e punës së partnerëve dhe ka mundësuar krijimin e një rrjeti që përfshin shoqëri civile dhe aktorët institucionalë. Këto shkëmbime kanë çuar në identifikimin e piketave të përbashkëta dhe zhvillimin e një reflektimi të përbashkët mbi metodat për të luftuar kundër trafikimit të qënieve njerëzore.